



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**Proces verbal**

Sot me datë 24.03.2026 ora 13:30 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Nga administrata e Bashkisë nuk kishte të pranishëm.

*Të pranishëm janë:*

Z. Oltion Luli  
Znj. Irena Shala  
Znj.Valjeta Bajraktari

*Mungon:*

Znj.Violeta Përndrecaj  
Z.Gjergj Sokoli  
Z. Edmond Ndou

Kourumi i domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes nuk është prezent, prandaj **Z.Luli** në cilësinë e Kryetarit vijon me citimin e rendin të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Po ashtu vendoset edhe data e mbledhjes , e cila do të mbahet ditën e Hënë, datë 30.03.2026, me rend dite si më poshtë:

*Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 27.02.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.*

- 1. Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2026”.*
- 2. Projektvendim: “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026”.*
- 3. Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB-në nr.8 datë 26.01.2026 “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë për vitin 2026”.*
- 4. Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB-në nr.84, datë 18..12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.*

5. *Projektvendim: "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Shkodër"*.
  6. *Projektvendim: "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Shkodër"*.
  7. *Projektvendim: "Për miratimin e programit të transparencës në Bashkisë Shkodër"*.
  8. *Projektvendim: "Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për Bashkinë Shkodër"*.
  9. *Projektvendim: "Për miratimin e planit lokal, programi 5-vjeçar i strehimit social 2026-2030, në Bashkisë Shkodër"*.
  10. *Projektvendim: "Për miratimin e planit të mbrojtjes sociale 2026-2030, në Bashkinë Shkodër"*.
  11. *Projektvendim: "Për miratimin e planit lokal të Rinisë 2026-2030, në Bashkisë Shkodër"*.
  12. *Projektvendim: "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2026-2030, në Bashkinë Shkodër"*.
  13. *Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB-në nr.22, datë 18.04.2019 "Për miratimin e planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar të Bashkisë Shkodër"*.
- *Diskutime jashtë rendit të ditës.*\_\_\_\_\_

**Znj.Shala** u shpreh se në mbledhjet e kaluara kemi kërkuar informacion për të ardhurat që sjellin shtëpizat e drurit, shezllonet në Velipojë dhe nga shoqëria aksionere "Skodrinon". Prandaj shpresojmë që në këtë mbledhje të marrim përgjigje.

Po ashtu ajo kërkoi që dokumentacioni i mbledhjes, duhet të vijë kohë pranë Këshillit Bashkiak për efekt shqyrtimi nga ana tyre.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, mbledhja e Kryesisë deklarohet e mbyllur.

**SEKRETARE**

**Zbardhi procesverbalin:**

**Sabina Danaj**

**Irma Sulishti**